



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.2021

VENDIM
Nr. 605, datë 23.12.2021

PËR
CAKTIMIN E GJYQTARËVE TË SKEMËS SË DELEGIMIT Z. ENGERT
PËLLUMBI DHE Z. FLORJAN KALAJA, PËR GJYKIMIN E DISA ÇËSHTJEVE
GJYQËSORE NË GJYKATËN ADMINISTRATIVE TË APELIT

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenet 61 dhe 97 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në shkronjën “a”, të pikës 4 dhe pikën 7, të nenit 45, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe në nenin 13, të Vendimit të tij nr. 22, datë 07.02.2019, “Mbi miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurën e funksionimit të skemës së delegimit të gjyqtarit”, pas shqyrtimit të kërkesave të Gjykatës Administrative të Apelit, dërguar me Shkresat nr. 527 prot., datë 13.12.2021, nr.528 prot., datë 13.12.2021, nr.533 prot., datë 14.12.2021 dhe nr.540 prot., datë 15.12.2021, protokolluar në Këshill respektivisht me aktin nr. 5684 prot., datë 14.12.2021, nr.5683 prot., datë 14.12.2021, nr.5706 prot., datë 15.12.2021 dhe nr.5732 prot., datë 16.12.2021, mbi propozimin e Komisionit të Zhvillimit të Karrierës dhe mbas shortit të hedhur,

VENDOSI:

1. Gjyqtari i skemës së delegimit z. Engert Pëllumbi caktohet për të gjykuar për llogari të Gjykatës Administrative të Apelit çështjen gjyqësore nr. 178/85 regjistri themeltar, datë 19.06.2020, që u përket palëve: Padihtës: {...}; Të paditur: {...}, {...}, {...}; Objekti: “Shfuqizimin e urdhrit nr.661, datë 13.12.2018 “Për ndalimin e hedhjes në treg të lëndëve piroteknike dhe fishekzjarrë për përdorim civil, që rrezikojnë sigurinë, jetën dhe shëndetin e qytetarëve”, etj.”;
2. Gjyqtari i skemës së delegimit z. Florjan Kalaja caktohet për të gjykuar për llogari të Gjykatës Administrative të Apelit çështjen gjyqësore nr. 216 regjistri themeltar, datë 09.10.2020, që u përket palëve: Padihtës: {...}; I paditur: {...}; Objekti: “Shfuqizimi si i papajtuëshëm me ligjin të vendimit nr.4, datë 11.03.2019 “Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”;
3. Gjyqtari i skemës së delegimit z. Engert Pëllumbi caktohet për të gjykuar për llogari të Gjykatës Administrative të Apelit çështjen gjyqësore nr. 197 regjistri themeltar, datë 27.10.2017, që u përket palëve: Padihtës: {...}; I paditur: {...}, etj.; Objekti: “Anullimi dhe shfuqizimi i vendimit nr.1, datë 14.04.2017 të KKT-së, etj.”;
4. Gjyqtari i skemës së delegimit z. Florjan Kalaja caktohet për të gjykuar për llogari të Gjykatës Administrative të Apelit çështjen gjyqësore nr. 149 regjistri themeltar, datë 17.01.2020, që u përket palëve: Padihtës: {...}; I paditur: {...}, etj.; Objekti: “Shfuqizimin e pjesshëm të vendimit nr.74, datë 06.01.2017 të Këshillit të Bashkisë Krujë, etj.”;

5. Një kopje e vendimit i njoftohet gjyqtarëve të caktuar sipas kërkesave të shkronjës “c”, pika 1, neni 98, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në adresën postare elektronike zyrtare, si dhe Gjykatës Administrative të Apelit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR